

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

KleinR sh.p.k

Neni 1

Emri

1.1 Emri i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është KleinR sh.p.k, këtu e më poshtë e referuar kudo në këtë Statut edhe si (“**Shoqëria**”). Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj, të cilat së bashku me të dhëna të tjera të parashikuara në ligj, do t'i bashkëngjiten çdo dokumenti të shoqërisë drejtuar të tretëve.

Neni 2

Forma Ligjore

2.1 Shoqëria “KleinR”, është shoqëri me përgjegjësi të kufizur “sh.p.k”.

Neni 3

Themelimi

3.1 Data e Themelimit të Shoqërisë është 17/06/2020. Themelues i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:


- **Masayuki Kuroda**, i datëlindjes 04-10-1975, shtetas Japonez, mbajtës i pasaportës me Nr. TR2217101, banues në Japoni, në adresën 1-326, Takamori 1 Chome, Takamori Park House 3-402, Izumi-ku, Sendai Japan, i cili përfqësohet në këtë dokument nga **Alfred Mustafa**, lindur më 21-06-1971, shtetas shqiptar, me Letërnjoftim Nr.034728765 dhe Nr.Personal: H10621156M, banues në Rr. Gjon Muzaka, Nr.10, Tiranë përfaqësues i autorizuar, sipas emërimit dhe të drejtave të dhëna nëpërmjet **Prokurës së Posaçme** datë 3 Mars 2020 të lëshuar në Japoni.

3.2 Shoqëria themelohet dhe do të funksionojë bazuar në Ligjin Shqiptar. Ajo do të fitojë personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 4

Selia

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën, Rr. Donika Kastrioti, Nd.1, Ap.5, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, Shqipëri.



Neni 5
Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 6
Shtrirja Territoriale

6.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo ka të drejtë të themelojë ose mbyllë filiale, agjensi, qendra operative, zyra përfaqësimi të çdo lloji, si dhe vende dytësore zhvillimi aktiviteti.

Neni 7
Objekti i Veprimitarisë

- 7.1 Objekti i veprimitarisë së Shoqërisë është, përfshi por pa u kufizuar në, zhvillimin e të gjithë llojeve të produkteve software për tregun vëndas dhe ndërkombëtar. Këto do të janë produkte të veçanta për inxhinier software të cilët zhvillojnë software për paë të treta/klientë. Produktet e sipërmendura Software përfshijnë SpreadJS, ActiveReportJS dhe Data ViewJS, së bashku me software të tjera për zhvillues; si dhe projekte software me zgjidhje në lidhje me produktet dhe shërbimet e teknologjisë no-code dhe lo-code.
- 7.2 Shoqëria do të zhvillojë të gjitha llojet e Shërbimeve Software të Gjuhëve të huaja dhe të Programeve të gjuhës Angleze. Shërbimet Software të Gjuhëve do të ofrohen në marrëdhëniet ndërmjet bizneseve si dhe direkt te Operatorët e Konsumatorëve, përfshi por pa u kufizuar në, GrapeSEED dhe Rosetta Stones. Zhvillimin e shërbimeve Software të sipërmendura që përfshijnë morfolojinë, testimin dhe progresin e arritur nga mësuesit dhe studentët, si dhe licencimin e tij për GrapeSEED, Rosetta Stones dhe operatorë të tjerë.
- 7.3 Shoqëria do të veprojë gjithashtu si rishitës për GrapeSEED, Rosetta Stones dhe shoqëri të tjera në vëndet e përzgjedhura për të cilat ka një Marrëveshje.
- 7.4 Shoqëria do të blejë, shesë dhe të zotërojë në pronësi të gjitha llojet e pasurive të paluajtshme. Ajo do të kryejë investime në lidhje me zhvillimin dhe përmirësimin e pasurive të paluajtshme. Ajo gjithashtu do të përfshihet në të gjitha llojet e administrimit dhe të aktivitetave tregtare që kanë lidhje me pasuritë e paluajtshme.

Neni 8

Vlera e Kapitalit të Regjistruar/Nënshkruar të Shoqërisë

- 8.1 Kapitali i regjistruar/nënshkruar i Shoqërisë ka një vlerë totale prej EUR1000 (njëmijë).
- 8.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është **Z. Masayuki Kuroda**. E gjithë vlera e kapitalit të regjistruar/nënshkruar të Shoqërisë do të shlyhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, jo në momentin e themelimit dhe të regjistrimit të shoqërisë, por brenda afatit të parashikuar në nenin 9 të këtij Statuti.
- 8.3 Kapitali i regjistruar/nënshkruar i shoqërisë ndahet gjithësej në një (1) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.
- 8.4 Vlera e kontributit të nënshkruar të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, në Kapitalin e regjistruar të Shoqërisë është gjithësej EUR1000 (njëmijë).

8.5 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, në bazë të vlerës së kontributit që nënshkruan në kapitalin e shoqërisë, sipas përcaktiveve mësipër në Klauzolën (8.4), do të zotërojë një kuotë me vlerë nominale sipas sa vijon:

- a) Ortaku i Vetëm Masayuki Kuroda zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej EUR1000 (njëmijë), e cila përfaqëson 100% të vlerës së kapitalit të regjistruar/nënshkruar të Shoqërisë.

Neni 9


Shlyerja e Kontributit nga Ortaku

- 9.1 Ortaku Themelues detyrohet të shlyejnë kontributin e tij të nënshkruar në kapitalin e regjistruar/nënshkruar të shoqërisë, sipas vlerës së përcaktuara në klauzolën (8.4), të këtij Statuti dhe nëpërmjet dhënies së kontributit në para.
- 9.2 Ortaku Themelues detyrohet të bëjë shlyerjen e kontributit të nënshkruar brenda tre muajve nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 9.3 Ekzekutimi i pagimit të referuar mesipër nga Ortaku Themelues duhet të bëhet nëpërmjet derdhjes së shumës në llogarinë bankare të shoqërisë, dhe sipas përcaktiveve në Klauzolën (8.4), të këtij Statuti.

Neni 10

Transferimi

- 10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;



- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 11
Shpërndarja e Fitimeve

11.1 Ortaku i Vetëm ka të drejtën që të vendosë për shpërndarjen e çdo fitimi të shoqërisë, që rezultojë sipas pasqyrave financiare të shoqërisë, me kusht që të zbatojë të gjitha rregullat dhe kufizimet e parashikuara në Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Neni 12
Ortaku i Vetëm

12.1 Meqënëse kapitali i regjistruar i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, ky i fundit do të ushtrojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara për Asamblenë e Përgjithshme në dispozitat e zbatueshme të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

12.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin i likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët, Likujduesve dhe Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës;
- h) Zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë në rast të procedimeve ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale në lidhje me funksionimin e organeve të shoqërisë;
- m) Çdo çështje tjetër që është kompetencë e tij sipas ligjit ose statutit.

12.3 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një Regjistër të Vendimeve, sipas rregullit kronologjik.

Neni 13
Administratori

13.1 Ortaku i Vetëm emëron një individ si Administrator të Shoqërisë.

13.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për kohëzgjatje prej dy vjet (2) vjet, dhe është i rizgjedhshëm.

13.3 Administratori i Shoqërisë ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- b) Të bëjë përfaqësimin ligor të shoqërisë, në të gjitha marrëdhënet ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, dhe sipas kufizimeve të vendosura kohë pas kohe nga Statuti dhe Ligji. Administratori me Prokurë të Posacme mund të delegojë në çdo kohë tek persona të tjera të përzgjedhur prej tij, një pjesë të të drejtave të tij, që i nijhen sipas ligjit dhe statutit.
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të gjithë dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
- e) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për evidentimin në kohë të rrethanave që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë. Kur evidenton rrethana të tilla informon menjëherë Ortakun e Vetëm;
- f) Në mënyrë të vazhdueshme, kryen të gjitha regjistrimet dhe dërgon të gjitha të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raporton përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe statuti.

13.4 Administratori i Shoqërisë duhet të zbatojë të gjitha kufizimet e tagrave të tij të përfaqësimit, të përcaktuara në Ligjin Ligjt Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe ato të përcaktuara kurdoherë në statutin e shoqërisë.

13.5 Ortaku i Vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkaku.

13.6 Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë pesëvjeçare, emërohet **Pal Luka**, i biri i Gjinit, i datëlindjes 19-06-1957, shtetas shqiptar, me Leternjoftim Nr.033870662 dhe Nr/Personal F70619083J, banues në adresën Rr. "Qemal Stafa", Pall.19, Shk.3, Kati 3, Ap.25, Tiranë.

Neni 14
Prishja dhe Likujdimi

14.1 Prishja e Shoqërisë bëhet për rastet e parashikuara nga ligji dhe kurdoherë kur konsiderohet e arsyeshme nga Ortaku i Vetëm.

14.2 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

14.3 Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm. Miratimi i Likujduesit është kompetencë e Ortakut të Vetëm, me përjashtim të rasteve kur shoqëria tregtare prishet me vendim gjykate dhe emërimi i Likujduesit është kompetencë e kësaj të fundit. Nëse Ortaku i Vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likujdues.

14.4 Likujduesi në kryerjen e veprimtarisë së vet i nënshtronhet mbikëqyrjes së Ortakut të Vetëm.

14.5 Pas shlyerjes së detyrimeve të shoqërisë ndaj kreditorëve dhe shpërblimit të likujduesit, së bashku me rimbursimin e shpenzimeve të këtij të fundit për kryerjen e detyrave, aktivet e mbeturë i shpërndahen Ortakut të Vetëm.

Neni 15
Ekspertët Kontabël

15.1 Ekspertët Kontabël do të miratohen për rastet e parashikuara nga ligji dhe kur konsiderohet e arsyeshme nga Ortaku i Vetëm.

Neni 16
Viti Fiskal

16.1 Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor.

Neni 17
Dispozita të Fundit

17.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe dispozitat e Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, si dhe çdo Ligj tjeter të zbatueshëm.

17.2 Ortaku Themelues i Shoqërisë autorizon depozitimin e këtij Statuti pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit, për qëllim të kryerjes së regjistrimit të Shoqërisë.

17.4 Ky Statut hartohet në 6 kopje origjinale, nga të cilat katër janë në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën angleze, secila me vlerë të njëjtë. Ky Statut miratohet dhe nënshkruhet nga Përfaqësuesi i Ortakut të Vetëm, i cili vepron në bazë të emëritit dhe të drejtave të marra nëpërmjet Prokurës së Posacme datë 3 Mars 2020, lëshuar në Japoni. Ky Statut nënshkruhet sot më datë 17/06/2020.



ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
KleinR sh.p.k
Z. Masayuki Kuroda

Alfred Mustafa
Përfaqësues i Autorizuar
me Prokurë të Posaçme

ALFREDS MUSTAFA
Alfred Mustafe